

VENDIM
Datë 13.10.2023

PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESVE

Në mbështetje të nenit 115, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe nenit 15 të rregullores nr. 3152/5, datë 11.12.2018, “Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Komisioni i Votimit me përbërje:

Kasëm Berberi kryetar;

Alfred Progonati anëtar;

Alma Muça anëtar,

pas administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, për zgjedhjen e 3 anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kandidatët sipas numrit më të madh të votave të vlefshme, renditen në mënyrën si vijon:

I. Për anëtarin prokuror nga prokuroria e apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

Znj. Afërdita Ndoi 106 vota;

Z. Moisi Duda 122 vota.

II. Për anëtarët prokurorë nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

Znj Edina Kurti 95 vota;

Znj. Edlira Bako 35 vota;

Znj. Elsa Miha 76 vota;

Znj. Olger Eminaj 103 vota;

Z. Vatë Staka 98 vota.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 115, paragrafët 5 e 7, dhe 247, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15 të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni,

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues si anëtar prokuror nga prokuroria e apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

Z. Moisi Duda

2. Të shpallë fitues si anëtar nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

Z. Olger Eminaj

Z. Vatë Staka

3. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 13.10.2023, ora 14.57.

Kryetar: Kasëm Berberi

Anëtarë: Alfred Progonati, Alma Muça